



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA PATOS
SEKTORI I PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. _____ Prot.

Patos, më 27/07/2026

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

**OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje bazë materiale për ndërtim kuz në fshatin
Grizë Lënginas”.**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pllaka bashkuese dhe pllaka fundore 34946121-4

Materiale ndërtimi dhe produkte të ngjashme 44100000-1

Tuba kanalizimesh 44163130-0

**VLERA E FONDIT LIMIT: 5,649,485 (pesë milion e gjashtëqind e dyzet e nëntë mijë e
katërqind e tetëdhjetë e pesë) lekë pa tvsh, vënë në dispozicion nga burimet e veta për vitin
2026, për objektin: “Blerje bazë materiale për ndërtim kuz në fshatin Grizë Lënginas”.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2,
pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të
prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Patos** ka hartuar procesverbalin për
argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën
e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, i ndryshuar, nenit
26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, Operatori ekonomik duhet të paraqes xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare 2023, 2024, 2025, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë **jo më e vogël se 40% e fondit limit**. *Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, pra vlerën e 40% të fondit limit, në të paktën 1 (një) vit të periudhës së kërkuar të tre viteve financiare.*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

$$5,649,485 \times 40\% = 2,259,794 \text{ Lekë.}$$

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2.2 Vërtetim lëshuar për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor kështu e maturuara për vitin 2026, kudo ku operatori ushtron aktivitet, sipas regjistrimit në QKB, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. Nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, lidhur me afatet e kryerjes së pagesave të caktuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për vitin 2026.

(Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia në të cilën është regjistruar sipas QKB-se).

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” dhe në ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2 d).

Referuar sa më sipër, njësia e prokurimit gjykon se kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të vertetimit të shlyerjes së detyrimeve vendore për vitin 2025 prane bashkise/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për tju nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se ... % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

5,649,485 x 40% = 2,259,794 Lekë.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.2. Operatori ekonomik duhet të vetdeklaroj se merr përsipër furnizimin (dorëzimin ngarkimin dhe shkarkimin) e mallit objekt prokurimi me kostot e veta, të cilat do të dorëzohen në magazinën e Bashkisë Patos në prani të komisionit të ngritur për marrje në dorëzim, sipas nevojave të autoritetit kontraktor. Operatori ekonomik fitues duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor 24 orë para dorëzimit të mallit. Baza materiale e kërkuar duhet të jetë në përputhje

me zërat ne preventiv, të cilat do të shoqërohen me dokumentacionin përkatës që vërteton sasinë dhe cilësinë e materialit. Çdo material do të vlersohet dhe miratohet para marrjes në dorëzim nga komisioni i ngritur me urdhër të titullarit.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave te Prokurimit Publik”. Ky vetdeklarim kërkohet per ti vertetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës përsa i përket dorëzimit të mallrave objekt prokurimi.

2.3.3. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës dhe transportin e materialit, duhet të disponojë në pronësi ose me qera, mjetet e mëposhtme:

Nr.	Lloji i Makinerive	Pronësia	Njësia	Sasia e kërkuar
1.	Kamionçinë më kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	Pronësi ose me qira	copë	1 (një)
2.	Kamion vetshkarkues me kapacitet 10-20 ton	Pronësi ose me qira	copë	2 (dy)
3.	Kamion me vinç	Pronësi ose me qira	copë	1 (një)

a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet:

- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit: (akti i pronësisë);
- leje qarkullimi;
- çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme);
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b. Për mjetet e deklaruara me qera duhet të paraqitet:

- kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi;
- dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë)
- leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme)
- siguracion mjeti (i vlefshëm);
- çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor gjate procesit te vleresimit te ofertave.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe pikës 5/ç nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, mjetet dhe pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Këto mjete janë kërkuar nisur nga sasia e konsiduereshme e mallrave objekt prokurimi. Gjithashtu furnizimi i sasisë së materialit objekt prokurimi kërkon si nevojshmëri për realizimin e kontratës dy mjetet të cilët do të shkarkojnë materialin dhe tubove HDPE qe jane me gjatesi te madhe në prani të komisionit dhe stafit teknik të Agjencisë së Shërbimeve Publike të cilët do të kryejnë proceset e tjera.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesi autorizim prodhuesi ose autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit/distributorit si: telefon, fax, email, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Për materialet si :

- a. Tub HDPE SN8 d=200mm
- b. Tub HDPE SN8 d=315mm
- c. Tub HDPE SN8 d=400mm
- d. Kapak gize d=40cm
- e. Kapak gize d=60cm
- f. Pusete shkarkimi 0.8x0.8x1.5 m (e parapergatitur)
- g. Pusete shkarkimi 1x1x1.5 m (e parapergatitur)

Katalogun/et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit si dhe skedën teknike për listën e mësipërme, në të cilët të tregohen dhe specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, në rastin kur janë në gjuhë të huaj ato duhet të përkthehen dhe noterizohen në gjuhën shqipe.

ARGUMENTIM: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6/b dhe pika 8, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.3.5. Operatorët ekonomik pjesmarrës në procedurën e prokurimit duhet të dorëzojnë në ambjentet e magazinës pranë Bashkisë Patos në datën 03/08/2025 deri në orën 09:00, (para hapjes së fazës së vlerësimit nga KVO përkatëse) mostrat për zërat si më poshtë minimalisht me gjatësi 1 (një) ml për tubot dhe nga 1 (një) copë për materialet e tjera :

- a. Tub HDPE SN8 d=200mm
- b. Tub HDPE SN8 d=315mm
- c. Tub HDPE SN8 d=400mm
- d. Kapak gize d=40cm
- e. Kapak gize d=60cm
- f. Pusete shkarkimi 0.8x0.8x1.5 m (e parapergatitur)
- g. Pusete shkarkimi 1x1x1.5 m (e parapergatitur)

Ky kriter i shërben Autoritetit Kontraktor për rëndësinë dhe cilësinë e këtij produkti ndaj është e nevojshme sjellja e mostrave.

Shënim: Ky kriter përbën kusht skualifikimi në rast se mostrat e dorëzuara nuk janë sipas specifikimeve teknike të kërkuara. Mosparaqitja mostrave përbën kusht për skualifikim.

Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Shënim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës përkatëse të DST dhe dokumentacioni i kërkuar do

të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar i pari përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në piken 6 gërma a, të nenit 40 të VKM nr 285 date 19.05.2021 “Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar në të cilën është e përcaktuar se: 6 Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve, pas nënshkrimit të kontratës ose marrëveshjes kuadër, me kusht që kontrata në fjalë ose marrëveshja kuadër të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.³⁸ Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

Specifikime teknike:

Materialet duhet të plotësojnë kriteret dhe specifikimet e mëposhtme:

- **Tuba të brinjëzuar HDPE SN8 d=200 mm, d=315mm, d=400 mm.**

Diametri	200, 315, 400 mm
Materiali	HDPE (Polietilen me densitet të lartë)
Gjatësia	6 ml
Standarti	GB/T13663-2000,ISO 4427-1:2007
Trashësia	2.3-57.2mm
Rezistente ndaj temperaturës	-25 °C – 55 °C

Jetëgjatësi të lartë. Duhet të jetë rezistente korrozionit, rezistencë kimike, fortësi fizike, rezistencë ndaj kushteve atmosferike dhe rrezeve UV. Materiali duhet të jetë fleksibël dhe rezistent ndaj vibrimeve. Pamja e jashtme të jetë e lëmuar dhe padëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit, ngjyrë e zezë dhe vija blu. Duhet të kenë rezistencë të lartë ndaj grryerjes.

Tubat HDPE duhet të vërtetojnë rezistencën e tyre ndaj presioneve të larta dhe deformimit mekanik ndaj forcave statike e dinamike.

Tubat duhet të jenë konform me standardin EN 12201 ose ekuivalent.

Asfaltobeton

Specifikimet teknike të asfaltobetonit

1. Përbërja

- Agregate të thyer (gurë, zhavorr, rërë): **93–96%**
- Bitum: **4–7%**
- Filler mineral (pluhur guri ose çimento): **2–10%** të përzierjes minerale

2. Granulometria

Për shtresën e konsumit përdoren zakonisht:

- AC 8
- AC 11
- AC 16

Për shtresën lidhëse:

- AC 16 Binder
- AC 22 Binder

Për shtresën bazë:

- AC 22 Base
- AC 32 Base

3. Llojet e bitumit

- 35/50
- 50/70 (më i përdoruri)
- 70/100

4. Temperatura

- Temperatura e prodhimit: **150–180°C**
- Temperatura gjatë shtrimit: **140–170°C**
- Temperatura minimale e mjedisit gjatë shtrimit: **5°C** (zakonisht rekomandohet mbi 10°C)

5. Dendësia

- **2.30 – 2.50 t/m³**

6. Përmbajtja e boshllëqeve

- **3–6%**

7. Trashësia e shtresave

- Shtresa e konsumit: **3–5 cm**
- Shtresa lidhëse: **5–8 cm**
- Shtresa bazë: **6–12 cm**

8. Karakteristikat mekanike

- Stabilitet i lartë ndaj deformimeve.
- Rezistencë ndaj konsumit.
- Rezistencë ndaj ujit dhe ngricës.
- Rezistencë ndaj lodhjes nga trafiku.

Parametri	Vlera
Lloji	AC 11 Surf 50/70
Madhësia maksimale e agregatit	11 mm
Bitumi	50/70
Përmbajtja e bitumit	5.2–6.2%
Dendësia	2.35–2.45 t/m ³
Trashësia e shtresës	4 cm
Standardi	EN 13108-1

Kapak gize d=40cm, d=60 cm

1. Përshkrimi

Kapaku i pusëtës duhet të jetë prej gize sferoidale (Ductile Iron), i kompletuar me kornizën përkatëse, i projektuar për përdorim në rrugë, trotuare dhe zona me trafik automjesh, sipas standardeve evropiane.

2. Materiali

- Gizë sferoidale (Ductile Iron) Grade EN-GJS-500-7 ose ekuivalent.
- Rezistencë në tërheqje ≥ 500 MPa.
- Kufiri i rrjedhjes ≥ 320 MPa.
- Zgjatja minimale $\geq 7\%$.

3. Përmasat

Kapak Ø400 mm

- Diametri i hapjes: **400 mm**
- Diametri i jashtëm sipas prodhuesit.
- Kompletohet me kornizë.
- Pesha orientuese: **20–40 kg**.

Kapak Ø600 mm

- Diametri i hapjes: **600 mm**
- Diametri i jashtëm sipas prodhuesit.
- Kompletohet me kornizë.
- Pesha orientuese: **45–90 kg**.

4. Karakteristikat teknike

- Sipërfaqe antirrëshqitëse.
- Kornizë dhe kapak me mbyllje të qëndrueshme.
- Hapje e lehtë për mirëmbajtje.
- Rezistencë ndaj korrozionit.
- Rezistencë ndaj goditjeve mekanike.
- Stabilitet pa lëvizje gjatë kalimit të mjeteve.

5. Veshja mbrojtëse

- Bojë bituminoze ose shtresë epokside kundër korrozionit.
- Sipërfaqe uniforme, pa çarje, pore ose defekte.

Pusete shkarkimi 0.8x0.8x1.5 m (e parapergatitur)

1. Përshkrimi

Puseta e shkarkimit duhet të jetë e parapërgatitur prej betoni të armuar, me përmasa të brendshme **0.80 × 0.80 m** dhe lartësi **1.50 m**, e destinuar për mbledhjen, inspektimin dhe shkarkimin e ujërave atmosferike ose të kanalizimeve, sipas projektit.

2. Materiali

- Beton i armuar me klasë minimale **C30/37**.
- Çelik armimi sipas **EN 10080**, klasa **B500B** ose ekuivalente.
- Agregate natyrale ose të thyer sipas **EN 12620**.
- Çimento sipas **EN 197-1**.

3. Përmasat

- Gjatësia e brendshme: **800 mm**
- Gjerësia e brendshme: **800 mm**
- Lartësia: **1500 mm**
- Trashësia minimale e mureve: **100–120 mm**
- Trashësia e bazës: **150–200 mm** (sipas projektit).

4. Karakteristikat teknike

- Rezistente ndaj ngarkesave të tokës dhe trafikut sipas projektit.
- Sipërfaqe e lëmuar pa çarje dhe defekte.
- Rezistencë ndaj ngricës dhe cikleve ngrirje–shkrirje.
- Rezistencë ndaj ujit dhe mjediseve agresive.

Puseta duhet të ketë:

- hyrje dhe dalje për tubacionet sipas diametrave të projektit;
- hapje të formuara ose të realizueshme në kantier pa dëmtuar strukturën.

Pusetë shkarkimi e parapërgatitur prej betoni $1.00 \times 1.00 \times 1.50$ m

1. Përshkrimi

Puseta e shkarkimit duhet të jetë element i parapërgatitur prej betoni të armuar, me përmasa të brendshme **1.00×1.00 m** dhe lartësi **1.50 m**, e destinuar për mbledhjen, inspektimin dhe shkarkimin e ujërave atmosferike ose të ujërave të kanalizimeve, sipas projektit të zbatimit.

2. Standardet

3. Materialet

- Beton i armuar me klasë minimale **C30/37**.
- Armaturë çeliku **B500B** ose ekuivalente.
- Çimento sipas **EN 197-1**.
- Agregate sipas **EN 12620**.
- Ujë për beton sipas **EN 1008**.

4. Përmasat

- Gjatësia e brendshme: **1000 mm**
- Gjerësia e brendshme: **1000 mm**
- Lartësia: **1500 mm**
- Trashësia minimale e mureve: **120 mm**
- Trashësia minimale e bazës: **150–200 mm**

5. Karakteristikat teknike

- Rezistencë e lartë mekanike ndaj ngarkesave të tokës dhe trafikut.
- Rezistencë ndaj depërtimit të ujit.
- Rezistencë ndaj korrozionit dhe sulmeve kimike të zakonshme në kanalizime.
- Rezistencë ndaj cikleve ngrirje–shkrirje.
- Sipërfaqe e brendshme e lëmuar për të lehtësuar rrjedhjen e ujit.

6. Hapjet për tubacionet

- Hapjet hyrëse dhe dalëse të realizohen sipas diametrave dhe kuotave të projektit.
- Lidhjet të jenë hermetike me guarnicione gome ose material hidroizolues të përshtatshëm.

Specifikimet dhe kriteret teknike u hartuan nga **DRJETORIA E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT DHE EMERGJENCAVE CIVILE** duke marrë në konsiderate nevojat e Autoritetit Kontraktor, ne perputhje me percaktimet e nenit 36 “Specifikimet teknike” te Ligjit Nr.162/2020, date 23.12.2020 “Per prokurimin publik”, i ndryshuar, e nenit 40 pika 2, si edhe te Nenit 44 “Kerkesat e cilesise” te VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Në përfundim, Njësia e Prokurimit vendosi unanimisht miratimin e dokumenteve të tenderit dhe si afat përfundimtar për dorëzimin e ofertave përcaktoi datën **07/08/2026, ora 09:00.**

I. Për të krijuar dosjen e tenderit në sistemin e prokurimit elektronik të APP dhe për të ngarkuar të gjithë dokumentacionin e procedurës së prokurimit me objekt “Blerje bazë materiale për ndërtim kuz në fshatin Grizë Lënginas**”.**

II. Njësia e Prokurimit autorizoi personin përgjegjës për prokurimin anëtar në NJP.

Bashkëlidhur këtij procesverbali:

Dokumentat e tenderit.

NJESIA E PROKURIMIT

Florian Kita

Boreta Murati

Imela Halimi